



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

1.1 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

1.2 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |

6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Edmond Hoxhaj, BIRN.

8. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

1.1 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

1.2 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet për sot vendimmarrje për 11 çështje. Gjithashtu kemi përfshirë në rendin e ditës edhe caktimin e disa gjyqtarëve për disa çështje që në fakt janë me urgjencë, të cilat janë shtuar në fund të rendit të ditës.

Atëherë, pa humbur kohë, nëse nuk kemi diskutime mbi përmbajtjen e rendit të ditës, unë në fakt do të ftoj zonjën Luli për çështjen e parë, e cila ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të dy ndihmësve ligjorë, {...} dhe {...}s, të cilat ne i kualifikuam në mbledhjen e kaluar, hapëm pozicionet dhe kanë shprehur interes për pozicionet.

Për më shumë detaje, zonja Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit Kryetare!

Një ndër përgjegjësitë që Kushtetuta i ka ngarkuar Këshillit është dhe administrimi i gjykatave. Në bazë të dispozitës nenit 147/a, pika 1, shkronja “d”, theksohet se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, [...]; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”

Në Ligjin për Pushtetit Gjyqësor, i ndryshuar, që në nenin 1, pika 1, shkronja “d” është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Edhe në nenin 50 e në vijim, deri në nenin 63, të këtij ligji i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civil gjyqësor në gjykatë. Në këto dispozita, lidhur me organin kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit është ngarkuar të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë është e sanksionuar në nenin 59 të këtij ligji ku theksohet se “1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.”.

Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për ndihmës ligjor, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kritere të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimit civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kritere të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji i parashikuar në pikën 2 të nenit 56, të Ligjit për Pushtetin Gjyqësor, i ndryshuar dhe (citojmë): “2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare”.

Bazuar në këto kritere të mësipërme, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë pranë Këshillit dhe më pas vetë Këshilli me vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, ka konstatuar faktin se të 2 kandidatët, konkretisht: znj. {...}, dhe znj. {...} plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për të ndjekur Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, profili “Ndhmës ligjor”. Gjithashtu konstatohet se në përfundim të Shkollës së Magjistraturës me Vendimin e saj nr. {...}, datë 18.07.2023, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022 – 2023”, Shkolla e Magjistraturës ka bërë renditjen e kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar. Sipas listës së dërguar nga Shkolla e Magjistraturës rezultojnë kjo renditje: 1) {...} me 77.17 pikë ose 78.6%; 2) {...} me 72.53 pikë ose 70.2%. (më shumë se 70% të pikëve totale që kërkon ligji).

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me disa vendimmarrje të tij, mbështetur ndër të tjera në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, si dhe në vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, ka vendosur për të 2 kandidatët fitues si

më poshtë: Për znj. {...}, paraprakisht me vendimin nr. 527, datë 06.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor, kurse me vendimin nr. 497, datë 28.09.2023 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor të saj në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit.

Për znj. {...}, paraprakisht me vendimin nr. 453, datë 14.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor, kurse me vendimin nr. 498, datë 28.09.2023 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit.

Lidhur me emërimin e tyre në gjykatat e apelit sjellim në vëmendje se kandidatët, për zbatim të nenit 64, pika 7, ligji nr. 98/2016, kanë depozituar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesat për emërim dhe trajtim financiar.

Nga ana e Këshillit konstatohet znj. {...} ka paraqitur kërkesën e regjistruar me aktin nr. {...} prot., datë 02.10.2023, në të cilën shprehet interesi për emërim si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe se znj. {...} ka paraqitur kërkesën e regjistruar me aktin nr. {...} prot., datë 29.09.2023, në të cilën shprehet interesi për emërim si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

Referuar kërkesave të sipërcituara për shprehje interesi për emërimin në pozicionin ndihmës ligjor në gjykatat si më sipër, dhe pasi kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin e tyre në këto pozicione, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civilë gjyqësorë dhe është konstatuar se ka një numër të konsiderueshëm pozicioneve të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Për sa më sipër, Këshilli me vendimin nr. 504, datë 28.09.2023 ka vendosur ndër

të tjera: “Shpalljen e 2 (dy) vendeve vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:

- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm - 1 (një) pozicion ndihmës ligjor;

- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit - 1 (një) pozicion ndihmës ligjorë;

Në këto kushte, në eventualitetin që znj. {...} dhe znj. {...} duhet të pranohen në shërbimin civil gjyqësor, i propozohet Këshillit miratimi i 2 (dy) projektvendimeve të cilat titullohen:

“Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”;

“Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”;

Struktura e projektvendimit:

Në pikën 1, të projektvendimit parashikohet pranimi i secilit prej kandidatëve në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit.

Në pikën 2, është përcaktuar efektet e juridike përfshirë dhe ato financiare.

Ndërkohë që në pikën 3, parashikohet që një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet kandidatëve sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 4, parashikohet e drejta e ankimit kundër vendimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në fund parashikohet se hyrja në fuqi e tij që është në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Bashkëlidhur relacionit janë edhe dy projektvendimet të cilat janë me strukturën që sapo citova.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë për datën e fillimit, si do e propozojmë?

Fillojmë që të hënën. Menjëherë apo vëmë datë?

Ta vëmë më datë 6?

Atëherë, jeni dakord? Kalojmë projekt-aktin e parë?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë më datë 06.10.2023. [...].

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë më datë 06.10.2023. [...].

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Edmond Hoxhaj, BIRN.

8. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës.

Nëse ne biem dakord që fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra shortin ta lëmë në fund, bashkë me caktimin e gjyqtarëve në gjykata, që mund ta

bëjmë edhe “online” për shkak të situatës që kemi, të kalojmë tek çështja nr. 3, që është shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Po filloj me prezantimin e relacionit.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 17, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile me vendimin e Këshillit të përmendur më lart, kandiduan gjithsej 7 (shtatë) kandidatë, të cilët janë pjesë e relacionit dhe nuk po i përmend një nga një.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr. 17/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë janë përfshirë kandidatët respektivë me dy vlerësime: z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (në atë kohë) dhe znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele për kandidatët të cilët kishin ose mund të bëheshin me dy vlerësime.

Për kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësisimit nga 3 (tre) prej kandidatëve të kritereve të mëposhtme, që janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja e masës disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë:

Kandidati z. {...}, që në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet të vendimit 320/2020 të Këshillit, u verifikua plotësimi nga ai të kritereve të kandidimit. Këshilli vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.17.

E njëjta situatë vlen edhe për zonjën {...} e cila edhe për të u verifikua plotësimi i kritereve formale të kandidimit. Si edhe për zonjën {...} u verifikua në të njëjtën mënyrë.

Me kualifikimin e kandidatëve në pozicionin respektiv nr. 17, bazuar në Vendimin e Këshillit “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 17.

Më datë 30.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 të vendimit të sipërcituar, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes në lëvizjen paralele për kandidatët në këto pozicione ka rezultuar se: Znj. {...} është renditur e para në pozicionin nr. 13 dhe Këshilli me vendimin nr.456, datë 24.07.2023 ka vendosur transferimin e saj në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sa më sipër në renditje për këtë pozicion mbeten kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

Lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatët: z. {...} ka rezultuar që ai ka dy vlerësime. Në vlerësimin e parë me vendimin e Këshillit nr. 481 datë 13.09.2023, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, zoti {...} është vlerësuar me 360 pikë. Gjithsej mori nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë” dhe me vendimin nr. 486, datë 21.09.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me 371 pikë.

Kandidatja e dytë zonja {...}, sipas vendimit të Këshillit nr. 335, datë 21.06.2023, është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me 380 pikë dhe sipas vendimit të KLGJ-së nr. 440, datë 19.07.2023, është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me 388 pikë.

Më pas, relatori, pasi mori edhe vlerësimet, vijoi procedurën për të përmyllur edhe përzgjedhjen e kandidatit në pozicionin nr. 17, hapur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, u përfshinë kandidatët, z. {...} dhe znj. {...}.

Në zbatim të kriterit të parë të renditjes që unë përmenda më lart, sipas atij të “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që zonja {...} të ketë "Shkëlqyeshëm" të dy nivelet e vlerësimit të mëparshme etike dhe profesionale, ndërsa z. {...} rezultoi të ketë nivelin "Shumë mirë" në vlerësimin periodik 2017-2019. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 17/2023, ku më lart renditet kandidatja zonja {...}, ndërsa kandidati tjetër z. {...} renditet pas saj.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 17, datë 18.01.2023, rezultoi si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...}.

Bazuar në përcaktimet e pikave 21-23, të këtij vendimi, sikundër edhe në rezultatin e renditjes, relatori përgatiti projektvendimin me renditjen përkatëse dhe propozimet përkatëse të cilat i bashkëlidhen këtij relacioni.

Në përfundim ne i propozojmë Këshillit të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Z. {...}.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve të përmendur më lart, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Këto janë propozimet tona.

Naureda Llagami: Faleminderit!!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve [...].

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.
[...].

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.4 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*
- 8. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*

RENDI I DITËS:

17

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.4 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me shqyrtimin e disa projektvendimeve, katër projektvendimeve:

Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës/Elbasan/Tiranë dhe Tiranë. Pra dy në Tiranë, një në Durrës dhe një në Elbasan. Për më shumë detaje, fjalën e ka zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë shkurtimisht një përmbledhje të relacionit që unë e paraqitur për t'u shqyrtuar në ditën e sotme.

Ekzistojnë disa gjykata, nga verifikimi që kemi bërë paraprakisht, pasqyrohet një shpërpjesëtim jo i drejtë i rritjes së numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësimi drastik i numrit të trupës gjyqësore, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme dhe të

papërballueshme të ngarkesës së trupës gjyqësore dhe cenuar në këtë mënyrë funksionalitetin e disa gjykatave. Ato janë gjykata të cilat ne kemi propozuar sot për të përdorur instrumentin e transferimit të përkohshëm. Këto gjykata janë: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Për këto gjykata, Këshilli në kohë të ndryshme ka ndërmarrë disa mekanizma për të përmirësuar funksionalitetin në to. Gjatë vitit 2023 shpallur 23 (njëzet e tre) pozicione të lira për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele në këto gjykata, si edhe 8 (tetë) pozicione për transferim me pëlqim, siç do të përmenden në mënyrë të detajuar në vijim të këtij relacioni.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si edhe kërkesave të implementimit të hartës gjyqësore ka përcaktuar numrin e gjyqtarëve për gjykatë, si më poshtë:

Me vendimin e Këshillit, nr. 146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, ndër të tjera është vendosur: “Numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është si më poshtë: “... 3. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, 23 (njëzet e tre) gjyqtarë. 4. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë...12. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 80 (tetëdhjetë) gjyqtarë...”

Me vendimin e Këshillit, nr. 286, datë 29.05.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë” është vendosur: “Numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë është si më poshtë: 1. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë.”

Situata në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe mekanizmat e përdorur:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Struktura Organizative: 23 gjyqtarë

Organika në fakt: 14 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 12 gjyqtarë.

Bashkëlidhur është edhe organigrama e gjykatës, numri i gjyqtarëve në këtë gjykatë si dhe pozicionet e lira apo pozicionet ku gjyqtarët mund të kenë jenë transferuar nga një gjykatë tjetër në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ku në organikën e saj janë 23 gjyqtarë, efektivisht në detyrë janë 12(dymbëdhjetë) gjyqtarë; Në këtë gjykatë ka 7 (shtatë) pozicione të lira të përhershme, nga të cilat 3 (tre) janë në proces për tu plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele; ka 7 (shtatë) vakanca të përkohshme për shkak të procesit të rivlerësimit, çështje penale apo leje të tjera. Më konkretisht nuk po ndalem. Në disa vendime janë përcaktuar edhe arsyt pse ekzistojnë vakancat e përkohshme në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës.

Gjatë vitit 2023 për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Këshilli ka përdorur dy mekanizmat: i) lëvizjen paralele; ii) transferimin e përkohshëm me pëlqim. Procedura është përmbyllur me sukses, në rastin e lëvizjes paralele, vetëm për 1(një) pozicion dhe vijon ende procedura për të tre pozicionet e tjera, ku kandidatët janë kualifikuar dhe po vijohet me vlerësimin etik dhe profesional të tyre.

Me vendimet nr.98/2023 dhe nr.99/2023 është vendosur: Transferimi i përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...}/z. {...}, për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, informohemi se ngarkesa e gjykatës është si më poshtë.

Ju e keni tabelën përkatëse, por mesatarisht një gjyqtar ka gjithsej 291.2 çështje në dorë për t'u gjykuar.

Situata në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Struktura Organizative: 18

Organika në fakt: 11 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 4 gjyqtarë.

Arsyet janë të përmendura për vakancat e përkohshme dhe të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Përgjithshëm Elbasan. Nuk po përmend emrat e gjyqtarëve në vakancat e përkohshme. Ato janë të pasqyruara në relacion.

Gjatë vitit 2023 për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Këshilli ka përdorur mekanizmin e lëvizjes paralele. Përkatesisht, Këshilli me vendimet nr. 248 – 253, datë 24.05.2023 hapi procedurat e lëvizjeve paralele për 6 (gjashtë) pozicione të lira në këtë gjykatë. Procedura është drejt përfundimit vetëm për 3 (pozicione); për 2 (dy) pozicione kandidatët janë kualifikuar dhe po vijohet me vlerësimin etik dhe profesional të tyre; 1 (një) pozicion ka mbetur pa kandidatë dhe do të vlerësohet në hapjen e vendeve për kandidatët e diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, informohemi se ngarkesa e gjykatës është si më poshtë. Mesatarisht numri i çështjeve në gjykim për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është 915 dosje në dorë.

Situata në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Struktura Organizative: 80 gjyqtarë

Organika në fakt: 59 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 37 gjyqtarë.

Në relacion janë përshkruar situatat e vakancave të përkohshme dhe të përhershme për gjyqtarët si dhe ata që priten të përfundojnë skemën e komandimit dhe të vijojnë ushtrimin e funksionit të tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; si dhe gjyqtarët që kanë leje të tjera: lindjeje (janë dy gjyqtarë).

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, informohemi se ngarkesa e gjykatës është si më poshtë. Numri mesatar i dosjeve për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është 469,6 dosje.

Situata në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Struktura Organizative: 27 gjyqtarë;
Organika në fakt: 23 gjyqtarë;
Efektivisht në detyrë: 19 gjyqtarë.

Arsyet e vakancave të përkohshme janë të përmendura për shkak të pozicionit të gjyqtarëve që janë larguar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nuk po i përmend emrat e gjyqtarëve një nga një dhe arsyet pse vakancat kanë mbetur përkohësisht të lira. Ato gjenden në relacion.

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ngarkesa e gjykatës është afërsisht 260 çështje/gjyqtarë. Bashkëlidhur është edhe tabela përmbledhëse. Kemi marrë tabelën përmbledhëse jo të gjykatës së fundit kur është bërë riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë administrative për shkak të efektit të hartës, por kemi marrë tabelat e gjykatave përpara se të bëhej ky riorganizim. Në korrik është bërë riorganizimi i gjykatave dhe s'kemi mundur t'i marrim tabelat. Por sipas informacionit që unë e thashë më lart, na ka rezultuar që afërsisht janë 260 çështje mesatarisht për një gjyqtar të shkallës së parë administrative Tiranë.

Mekanizmat ligjorë për plotësimin e pozicioneve të lira:

Në panoramën e gjendjes së këtyre gjykatave të prezantuar më lart, si edhe masave të përdorura nga Këshilli gjatë vitit 2023, rezulton se mekanizmi i lëvizjes paralele është një mekanizëm efektiv dhe i rëndësishëm, parësor, por që mund të na zgjasë në kohë.

Për sa më sipër, marrë në konsideratë statistikat aktuale të ecurisë së përfundimit të procedurave të lëvizjes paralele Komisioni vlerëson se këto të fundit do të kërkojnë një kohë të caktuar, pasi janë të ndërlidhura dhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë në rastin e vendeve të hapura në procedurat e lëvizjes paralele. Ndërkohë nga ana tjetër proceset e vlerësimit janë të ndërvarura edhe nga përfundimi i verifikimeve të iniciuara nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, për disa nga kandidatët që konkurrojnë në këto procedura, konfirmimi i të cilëve është tejet i rëndësishëm në lidhje me finalizimin e procedurave të vlerësimit dhe rrjedhimisht të procedurave të lëvizjes paralele me transferimin përfundimtar të gjyqtarit në pozicionin

e përhershëm ku ata kanë kandiduar. Duke vlerësuar eksperiencën aktuale në lidhje me kohëzgjatjen e madhe të procedurave të vlerësimit, parashikimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për përfundimin e tyre vlerësohet tej afatit të kërkuar për transferimin përfundimtar të kandidatëve duke vështirësuar në këtë mënyrë edhe procesin e caktimit të magistratëve të rinj (40) në pozicionet që do të krijohen nga lëvizja e tyre.

Me qëllim për të paraprirë procesin e lëvizjes paralele, si edhe për të përmirësuar situatën në këto gjykata, Komisioni propozon që në funksion të lëvizjes paralele dhe për të krijuar në një kohë sa më shpejt që të jetë e mundur lirim të pozicioneve të kandidatëve që konkurrojnë në këto procedura, për katër gjykatat e marra në analizë të përdoren procedurat e transferimit të përkohshëm referuar nenit 46 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Natyrisht qëllimi i kryerjes së këtyre procedurave të transferimit të përkohshëm do të jetë që nëpërmjet kombinimit të kësaj skeme me pritshmërinë e skemës së lëvizjeve paralele ku kandidatët konkurrojnë të vetëm, të mund të krijohen pozicionet e reja për magistratët e rinj. Parashikimi ynë është se aplikimi sa më shpejt i këtij kombinimi do të krijojë vendet e përhershme për caktimin e gjyqtarëve të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës. Natyrisht skema e propozuar respekton qëllimin e përcaktuar nga neni 42 i Ligjit për Statusin që të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit dhe zhvillimit të karrierës së gjyqtarit.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, rezulton se Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës/Elbasan/Tiranë dhe Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vijnë të klasifikohen si “gjykatë në nevojë”, në kuptim të shkronjës “a”, pika 2, neni 3, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr. 23, datë 07.02.2019.

Në situatën që ndodhen të katër gjykatat, Komisioni vlerëson se adresimi më i shpejtë në kohë i nevojave të tyre, mund të bëhet përmes transferimit të përkohshëm të një gjyqtari me pëlqimin e tij.

Sa i përket hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në rastin konkret, Komisioni vlerëson se ekzistojnë dy kushtet që e lejojnë atë, përcaktuar ato në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sikundër edhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Konkretisht, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit për Statusin, është përcaktuar se: “1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka gjyqtarë të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. ...”. Kurse në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, përcaktohet se: “1. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit. 2. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm”.

Duke ardhur në rastin konkret, konstatohet në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, pasi të 4 gjyqtarët e caktuar tashmë në skemën e delegimit, për shkak të nevojave imediate në pikëpamje të funksionalitetit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë caktuar për të gjykuar pranë këtyre gjykatave.

Për rrjedhojë, nevojat e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës/Elbasan dhe Tiranë, si edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit.

Në vijim, sikurse u përmend, në gjykatat e mësipërme, ka aktualisht një pozicion të lirë të përkohshëm.

Sa sipër, Komisioni vlerëson se për plotësimin e nevojave që paraqesin gjykatat e shkallës së parë të përmendura më lart, Këshilli duhet të orientohet paralelisht edhe në përcaktimet e Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, duke hapur kryesisht

procedurën e transferimit të përkohshëm në pozicionin e lirë të përkohshëm pranë këtyre gjyqate, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 5, të rregullores për transferimet. Në këtë këndvështrim, Komisioni propozon hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për nga 1 (një) pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si edhe Gjykatën administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës/Elbasan/Tiranë dhe Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturat që duhet të vijnë nga radhët e gjyqtarëve”.

Projektvendimet e propozuara janë të strukturuar në dy Krerë dhe 10 pika.

Janë bashkëlidhur dhe nuk besoj se është e nevojshme që t’i lexoj.

Ndërkohë, e vetmja situatë që doja ta diskutoja që nuk është pasqyruar në projektvendim është afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm. Nëse ky projektvendim i propozuar nga ana jonë do të marri konsensusin e të gjithë anëtarëve, ne do të propozonim që edhe afati i paraqitjes së kërkesave për transferimin e përkohshëm të jetë 5 ditë. Domethënë sot është data 5, deri në datë 10 t’i lëmë një afat kohor. Ne besojmë është i arsyeshëm dhe i mjaftueshëm për të gjithë kandidatët për të paraqitur kërkesat e e tyre, për t’u përfshirë në shpalljen e transferimeve të përkohshme.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Kemi diskutime?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Unë jam dakord parimisht me mekanizmin e propozuar nga KZHK, por kam një propozim ndryshe i cili mendoj që do të realizojë më mirë këtë pritshmëri, qëllimin e kësaj procedure. Sikundër edhe z.Kurushi e përmendi në relacion, qëllimi i kryerjes së këtyre procedurave të transferimit të përkohshëm është ai që nëpërmjet kombinimit të kësaj skeme me skemën e lëvizjeve paralele ku disa magjistratë konkurrojnë të vetëm, ne të hapim vende vakante për magjistratët e rinj dhe në fakt janë të individualizuara katër pozicione, një në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, një në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, një në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dhe një në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, ku ne në procedurat e lëvizjeve paralele kemi vetëm një kandidat që plotëson kushtet, që mund të ketë dy vlerësime apo një vlerësim, dhe për atë kandidat është çështje kohe se kur finalizohet lëvizja paralele e ndërvarur kjo nga përfundimi i procesit etik dhe profesional që merr kohën e vet.

Në këto kushte, unë mendoj që, nuk është e nevojshme që ne të shpallim procedura për të gjithë gjyqtarët, por këtë propozim për transferim të përkohshëm t'ia drejtojmë pikërisht atij gjyqtari i cili në skemën e lëvizjes paralele ka pritshmëri shumë të sigurt për të shkuar në atë pozicion, sepse është gjyqtar i vetëm i kualifikuar, që plotëson kushtet dhe pavarësisht nga shkalla dhe koha se kur do të përfundojë vlerësimi i tij profesional do të shkojë.

Tani, a jemi brenda mekanizmit ligjor në këtë rast? Mendoj se jemi, sepse ju sjell në vëmendje procedurën që ne ndjekim kur ne përsërisim transferimin e përkohshëm. Ne kur bëjmë transferimin e përkohshëm, e shpallim për një vit, sepse aq na kërkon ligji, bëjmë shpalljen për të gjithë gjyqtarët. Kur ne e përsërisim transferimin e përkohshëm, në fakt, ne e rishpallim po atë pozicion dhe ia kundër drejtojmë kërkesën për shfaqje vullneti të njëjtë gjyqtar i cili ka qenë në skemën e transferimit të përkohshëm për 1 vit.

Nga ana tjetër, neni 46, pika 1 na mundëson që ne këtë kërkesë për shfaqje vullneti për ta transferuar, t'ia drejtojmë një magjistrati që plotëson kushtet për atë pozicion dhe që tashmë Këshilli vendimet e kualifikimit i ka, të secilit pozicion të lëvizjes paralele.

Prandaj edhe për të fituar kohë, edhe për të qenë korrekt me të gjithë gjyqtarët që në fakt në këto katër pozicione i duam dhe të kemi mundësi t'i përdorim për magjistratët e rinj që pritet të emërohen, mendoj që për secilin, duke qenë se janë pozicione të individualizuara, vullneti për të shfaqur pëlqimin për transferimin e përkohshëm, t'i drejtohet gjyqtarit specifik.

Ata që janë në Durrës dhe Elbasan, t'i drejtohem të dy gjyqtarëve që konkurrojnë në Durrës dhe Elbasan dhe pastaj të ketë një zgjedhje midis tyre. Në eventualitetin që nuk do ketë ndonjë zgjedhje midis tyre, vendos Këshilli sipas procedurave që kemi ndjekur.

Mendoj që është edhe më e ndershme për të gjithë gjyqtarët kjo gjë, që të jemi transparent me mekanizmin që po përdorim. Kemi katër gjyqtarë që plotësojnë kriteret në lëvizje paralele, të cilët është çështje kohe, kur mbaron vlerësimi, automatikisht vijnë. Nuk konkurrojnë me njëri tjetër në këto procedura. Dhe mund t'i shkurtojmë edhe më shumë kohën. Jemi transparent dhe jemi brenda mekanizmit. Është diçka që ne kemi bërë në fakt kur kemi përsëritur transferimin.

Alban Toro: Jam kundër sepse, e para, kjo deformohet si skemë pastaj.

Në qoftë se ne do themi që, po të thërrasim vetëm dy, pra Albani, jep pritshmëri që është i vetëm në konkurrim në lëvizje paralele dhe do të shkosh në pozicionin, pra besohet që pritshmëria është e tillë dhe qasja është e tillë që do shkosh në atë pozicion, ne kemi pastaj anashkaluar kriterin e skemës së transferimit. Këtu nuk po bëjmë përsëritje të skemës së transferimit të përkohshëm që ne t'i themi një gjyqtari me dedikim që urdhëro, konkurro, hajde dhe të jesh ti gjyqtari i këtij pozicioni për hir të vazhdimësisë. Se kjo skemë ajo ka pas. Pra përsëritja ruan vazhdimësinë e gjykimit për ato procedura që ai ka qenë në atë pozicion në atë gjykim. Skema e transferimit ngrihet mbi bazën e ngarkesës më të ulët të gjykatës, apo jo. Në qoftë se na vjen në konkurrim, bashkë me Albanin, na vjen Ridvani që ka një ngarkesë më të ulët, si do bëjmë, si do i themi? Që ti Ridvan na vjen keq por, megjithëse ke ngarkesën më të ulët...

Atë gjë ne e kemi zgjidhur në formë më indirekte, ku themi që preferohen, pra kemi ca shkallë preference, kandidatët të cilët kanë aplikuar...

(Flasin pa mikrofona.)

Në qoftë se vijë një që plotëson kriteret më mirë, nuk kemi çfarë i bëjmë pastaj.

(Flasin pa mikrofona.)

Atëherë, ata që kanë sy për të lexuar shikojnë që preferuakan këtë procedurë të veçantë vetëm këta zotërinj që kanë kandiduar në lëvizje paralele dhe kanë një pritshmëri të caktuar. Por që t'i themi tani me dedikim (Albanit) sepse paska kandiduar në lëvizjen paralele dhe ka pritshmëri ta zërë atë pozicion, të caktohet në pozicion, dalim nga skema pastaj.

Kemi thënë në relacion që do plotësohen edhe kriteret përkatëse dhe nuk bëhet pastaj në qoftë se s'plotësohen kriteret.

(Flasin pa mikrofona.)

Hajde t'i vëmë emër tjetër pastaj.

Marçela Shehu: Shkurtimisht.

Për sa kohë qëllimi është që në ato pozicione të shkojnë si të transferuar pikërisht ata gjyqtarë, atëherë procedura standard e transferimit e humb vlerën.

Alban Toro: Formalisht Marçela do të ruajmë edhe kriteret që kërkon skema.

Marçela Shehu: Jam shumë dakord.

Alban Toro: Nuk kemi përsëritje transferimi këtu. Këtu kemi një thirrje të re, bazohet tek nevoja e gjykatës.

Marçela Shehu: Ky është mjeti më i mirë për ta bërë edhe më shpejt dhe më efiçente.

Alban Toro: Mos e quaj transferim pastaj.

Të gjejmë një nocion tjetër. Del jashtë transferimit, sepse po i drejtohem Marçelës, hajde këtu, sepse ke pritshmëri të vish.

Marçela Shehu: Siç e themi kur e ripërsërisim, e tha edhe Brikena.

Alban Toro: A i shikojmë kandidaturat që do vijnë, se sa të krijojmë këto lloj... Domethënë, janë ca formalizma që po shtojmë, janë ekstra, nuk e ke në procedurë.

Marçela Shehu: Në procedurën e transferimit standard të përkohshëm, ne nuk arrijmë qëllimin.

Alban Toro: Marçela, është ekstra procedurale.

Marçela Shehu: Nuk është ekstra procedurale.

Alban Toro: Ma gjej dispozitën.

Marçela Shehu: E kemi aplikuar edhe herë tjetër, pra të njëjtit gjyqtar i themi “A kërkon të transferohesh?”; “Do japësh pëlqimin?”

Alban Toro: E ka të parashikuar ekspressis verbis tek 46-ta përsëritjen.

Marçela Shehu: Jam dakord.

Alban Toro: Dhe kjo është që të ruash vazhdimësinë në gjykim.

Marçela Shehu: Edhe këtu Alban, me interpretim, për sa kohë ti do transferosh filan gjyqtar për këtë qëllim, atëherë pse duhet t’i drejtohem 10 gjyqtarëve të tjerë?

Alban Toro: Po, sepse e përmban skema e transferimit.

Atëherë, kur bëj një thirrje jam i detyruar t'i drejtohem ca gjyqtarëve, të cilët...

Marçela Shehu: Dhe në finale do çosh po atë që mendon që do çosh.

Alban Toro: Do ta vlerësoj pra.

Marçela Shehu: Unë e kuptoj shumë mirë.

Alban Toro: Kam bërë një preferencë. Do preferoj Marçelën në vend të Albanit, sepse Marçela ka konkurruar dhe ka pritshmëri të shkojë tek ai vend.

Brikena Ukperaj: Edhe ky preferimi është pjesë e skemës së transferimit.

Problemi është këtu, qëllimin pse e përdorim mekanizmin e skemës së delegimit, se në një situatë tjetër, mos të ishte ky qëllim, unë do thosha kundër, sepse ne kemi vendosur standard, do hapim procedura lëvizje paralele. Në thelb ato nuk janë pozicione të lira të përkohshme, për sa kohë në atë pozicion ke gjyqtar me 75% dhe kur ai e transferon, shkon në vend të lirë të përhershëm.

Ideja është që ne jemi për një qëllim tjetër këtu dhe për këtë qëllim tjetër unë mendoj, kemi dhe detyrimin për të qenë transparent me të gjithë trupën gjyqësore, mendoj që të ... (i ndërpritet fjala..)

Naureda Llagami: Jo vetëm me qenë transparent, por edhe duhet të sqarojmë situatën që, lëvizjet paralele kanë qenë një procedurë shumë komplekse për Këshillin. Ne kemi pasur të gjithë problematikat e lëvizjeve, ne është hera e parë që i zbatojmë lëvizjet paralele, dhe kemi vonesa në pjesën e vlerësimit të tyre, sepse shumë persona kanë hequr dorë nga lëvizja; kemi nisur me vlerësimin e disave; kanë hequr dorë, kemi vazhduar tek vlerësimet e tjera. Pra këto janë vështirësi që Këshilli po i ndjek përditë në plotësimin e vendit vakant tek lëvizjet paralele. Në qoftë se qëllimi, të paktën sa u parashtrua tek

30

kryetari i komisionit, është që përdorimi i këtij mekanizmi do të jetë pikërisht për të plotësuar ato lëvizje paralele që akoma janë në vijimësi për vlerësimet dhe nuk mund të jenë persona të tjerë, sepse janë të vetëm në pozicionet e tyre, atëherë, hajde gjejmë mekanizmin më eficient që neve të kalojmë më shpejt për të hapur vendet vakante për magjistratët. Se qëllimi ky është pra.

Fjalën e ka Irena.

Irena Plaku: Edhe unë faktikisht me relacionin për hapjen e vakancave me transferim të përkohshëm, parimisht në çdo transferim të përkohshëm unë nuk jam dakord absolutisht, por duke pasur parasysh qëllimin për hapjen e vendeve vakante dhe për sa kohë që ne kemi lëvizje paralele, nuk mund të funksionojë, nuk mund të tejkalojmë lëvizjet paralele. Por meqenëse situata lidhet me magjistratët, jam dakord dhe jo t'i drejtohet të gjithë magjistratëve, për sa kohë që ne duhet të mbyllim pikërisht ato pozicione të cilët kanë konkurruar të vetëm në lëvizje paralele, por jam dakord t'i drejtohet vetëm atyre. Sepse po të nisemi pas tek plotësimi i kritereve, po të shikojmë (pa përmendur emra) t'i drejtohem gjykatës Dibrës apo Lezhës (po marr shembull), do shikojmë që ngarkesa e tyre është tej më e madhe, do jemi në ato kushte që nuk do formojmë dot as trupa gjyquese. Kështu që do i përjashtojmë automatikisht ato gjyqtarë për shkak të ngarkesës që këto gjykata kanë. Kur është bërë relacioni në fakt janë marr të dhënat nga gjykatat që kanë nevojë, por duke u nisur (se është thënë edhe në relacion) për të evituar apo për t'i drejtuar atyre gjyqtarëve të cilët janë të vetëm në procedurë vlerësimi, do shikojmë që te ato gjykata që janë të vetme në procedurë vlerësimi, ngarkesa është më e madhe sepse domethënë më shumë prishim punë në fakt sesa rregullojmë punë. Por meqenëse ne duhet të përshpejtojmë këtë procedurë të lëvizjes paralele duke përdorur për më pas për caktimin e magjistratëve, pasur parasysh edhe vonesat që janë shkaktuar, jam dakord që për lëvizjet e përkohshme t'i drejtohem pikërisht atyre gjyqtarëve të identifikuar dhe jo të duket sikur po i drejtohem të gjithëve.

Duket, sa për formalitet dhe gjoja më pas do i bëjmë vlerësimin e kushteve, kur ne vetë do jemi në vështirësi në vlerësimin e kushteve përkatëse për secilën nga këto

grykata, ku në ato grykata që ne ia drejtojmë, në thonjëza, do shikojmë që ngarkesa është shumë herë më e madhe se tek grykata që do i caktojmë dhe numri i gryqtarëve është më i paktë në krahasim me raportin e çështjeve të caktuara. Kështu që unë jam dakord që për këtë rast, vetëm për këtë rast, pasur parasysh nevojave, vendet vakante për magjistratët, të përdorim lëvizjen e përkohshme, caktimin e përkohshëm, duke iu drejtuar pikërisht atyre gryqtarëve të cilët janë në ato pozicione të lëvizjes paralele (që janë të vetëm në atë pozicion) dhe ka mundësi që të përdoren më pas këto pozicione. Faleminderit!

Alban Toro: Nuk ke caktim të përkohshëm këtu Irena, se po ngatërro institutet. Është tjetër institut ai “caktimi i përkohshëm”.

Tani, nuk kuptova ç’lidhje ka konflikti midis transferimit të përkohshëm dhe lëvizjes paralele. Këtë s’e kuptova me thënë të drejtën, se janë dy institute të ndryshme. Pjesa tjetër pastaj e dedikimit ose thirrjes së çuar gryqtarit i cili ka konkurruar për atë pozicion nëpërmjet skemës së delegimit, unë nuk gjej ndonjë mbështetje ligjore, të paktën në ato dispozita që kanë rregulluar transferimin. Ajo i takon përsëritjes. Përsëritja, ka një logjikë pse e ka vendosur ligjvënësi, më i mençur se ne. Ka logjikën që i drejtohet gryqtarit për të mos krijuar pështjellimin në organizimin e asaj grykate në ecurinë e grykimit, i cili ndoshta s’ka mbaruar në atë moment kur këtij i mbaron afati, dhe vazhdon i zgjatet dhe i themi zotërisë hajde vazhdoje edhe “x” vite.

Tani, për të dekurajuar, të themi, konkurrime nga të tretët, natyrisht duke plotësuar edhe kriteret që kërkon skema e transferimit, ne kemi vendosur një kriter që ka të bëjë gjithmonë me këtë dekurajim. Ne themi, preferojmë në këtë konkurrim, të nderuar gryqtarë, ata që kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele, pikërisht për këto pozicione. Dhe themi që e kemi paqëtur qëllimin me skemën. Këtë synon kombinimi. Pastaj, çojmë me dedikim gryqtarëve të cilët kanë konkurruar, unë nuk e gjej këtë bazë ligjore. Kështu që shprehem kundër për atë pjesë. Megjithatë i takon Këshillit ta vendosi.

Irena Plaku: Në fakt, për bazë ligjore, kjo situatë nuk është normale. Absolutisht nuk është. Kjo situatë që ne jemi sot, duke përdorur këtë mekanizëm...

Alban Toro: Ky ligj nuk është bërë për emergjencat që ka sistemi.

Irena Plaku: Por edhe t’i drejtohesh më pas të gjithë gjyqtarëve dhe të zgjedhësh pikërisht ata gjyqtarë që ne duam, për përparësitë ligjore... ata në fakt e dinë që i plotësojnë të gjithë kriteret, sepse i kemi kualifikuar. Këto që ne i kemi për lëvizje paralele ne i kemi kualifikuar. Më pas, në rast se do vijë dikush tjetër dhe do thuash ka përparësi për lëvizje paralele, ne kemi shembuj të tjerë.

(Flitet pa mikrofonta ndezur.)

Klodian Kurushi: I dëgjova të gjithë kolegët, dhe unë po them mendimin tim në lidhje me arsyet pse e kemi bërë këtë projektligj. E para është çështje për t’u ndalur edhe tek ky projektvendimi, por nuk kishim mekanizëm tjetër ligjor përveçse kësaj shtate se si ta paraqesim transferimin e përkohshëm. Ta paraqisim në një formë tjetër, nuk kishim. Kështu që iu referuam ligjit dhe rregullores dhe bëmë ato çfarë thotë ligji dhe rregullorja. Kjo ishte pjesa e parë.

E dyta, nuk kemi kaluar tek faza e dytë e përzgjedhjes së kandidatëve referuar kritereve se si do t’i përzgjedhim për t’i sjellë në Tiranë. Është e vërtetë fakti që ne kemi bërë një projektion paraprakisht dhe projektioni është që për të sistemuar 40 magjistratët e rinj duhet të ecim pak më shpejt me mekanizmat e tjerë që kemi hapur me kohë. Por ja që nuk po ecim dot më shpejt, për arsye që nuk varen as nga ne, varen edhe nga ca aktorë të tjerë. Atëherë, çfarë do bëjmë? Ata do lëvizin. Domethënë, në projektionet tona kemi thënë që ata janë të sigurt të katërt që do lëvizin, atëherë ne po i lëvizim paraprakisht me këtë mekanizëm. Se të drejtuarit drejt për drejt në relacion unë nuk e gjej si t’i drejtohem. Kjo është çështje për t’u diskutuar dhe po e diskutojmë sot bashkërisht. Se vetë unë në relacion nuk e bëja dot bashkë me kolegët, dhe i thonë “Hajde t’i drejtohem neve me një thirrje atyre të katërtve”. Duhet një instrument ligjor. Një bazë ligjore është kjo. Ka diskutim brenda kësaj? Patjetër që ka! Është transparenca, e tha kolegja. Po, është transparenca dhe duhet të jemi të sigurtë me kolegët, sepse vijmë prej atyre dhe duhet

të jemi të sigurtë. Kjo bëhet për shkak të vonesës në procedura të lëvizjes paralele të tyre, ku situata është e sigurt që ata do vijnë në vendet ku ata kanë aplikuar.

Por nga ana tjetër kemi bërë edhe një projektion tjetër. Nëse këta i marrim, me të vërtetë e meritojnë apo jo, në kuptimin që kërkon edhe transferimi i përkohshëm. Kemi parë edhe ngarkesat e gjykatave (është projektion, është verifikim) dhe gjithsesi themi që jemi brenda objektivave tanë. Përtej faktit që ata e meritojnë sepse janë të sigurt në lëvizjen paralele, edhe me këtë mekanizëm tjetër, gjithsesi nuk do bënim diferenca të mëdha, të dukshme dhe të padrejta, në raport me ndonjë kandidat tjetër që do hynte në garë për transferimin e përkohshëm. Pse? Për fat, janë gjykata ku ne i marrim...

Po u shtrua si diskutim Irena kjo, dhe më duhet t'i jap një përgjigje edhe kësaj.

...i marrim nga gjykata që këta gjyqtarë kanë mundësi dhe nuk dëmtojnë gjykatat e tyre në raport me përdorimin e skemës së transferimit. Dhe do shkojë magjistrati nesër. Kjo është situata që ata zëvendësohen në një kohë shumë të shpejt me njëri-tjetrin. Ne i kemi të koordinuara, edhe pa vullnetin tonë i kemi të koordinuara veprimet. Duhet të vëmë njërin dhe pastaj ta mbulojmë këtë me një veprim tjetër shumë shpejt.

Irena Plaku: Atëherë, edhe unë atë që po them është që ne t'i drejtohem emrave, sepse duke ia drejtuar të gjithëve thirrjen, ne mund të kemi kandidatë nga gjykata të cilave vërtetë nuk u prishet fare funksionaliteti dhe neve më pas do zgjedhim nga një gjykatë të cilës mund t'i prishet funksionaliteti, duke qenë se ai është në lëvizje paralele.

Do të marr një shembull? Se nuk dua të përmend gjykata në këtë rast. Por që mund të ndodhë kjo situatë. Neve pastaj të zgjedhim ato që janë për lëvizje paralele, nuk ka kuptim. Sepse të njëjtën procedurë ne nuk e kemi ndjekur kur bëmë lëvizjet e përkohshme të mëparshme, nuk është se bëmë këtë ndarje që të themi që kemi një praktikë. Nuk i bëmë këtë ndarje. Por pamë funksionalitetin e gjykatave kur bëmë lëvizjet e tjera të përkohshme. Nuk u nisëm automatikisht kush ishte me lëvizje paralele. Pse do ndryshojmë situatën tani? Për të qenë transparent ne duhet të themi, pikërisht këto magjistratët të cilët i kemi të sigurt për lëvizjet paralele.

Klodian Kurushi: E kemi thënë në relacion.

E kemi thënë në relacion apo jo?

Por s'kishim mekanizëm tjetër Irena.

Irena Plaku: Ta themi në vendim.

Unë e kam lexuar, prandaj po them.

Por mos i shpallim këto vende për transferim të përkohshëm.

Marçela Shehu: Komisioni i ka thënë të gjitha në relacion.

Edhe unë bie dakord pikërisht se e kanë thënë vetë ata.

Naureda Llagami: Në relacion është thënë që qëllimi i hapjes së këtyre procedurave ka të bëjë pikërisht me shqetësimin që kemi për zgjedhjen e personave të cilët konsiderohen të sigurt në pozicionet e tyre dhe që kjo do lejojë më pas Këshillin për të krijuar vakancat e nevojshme, duke qenë se kemi brezin e ri që jemi akoma çdo ditë në pritje dhe që duhet patjetër që të marrim masa.

Diskutimi kryesor këtu është tek mekanizmi. A shkojmë tek një mekanizëm me hapje të përgjithshme, apo shkojmë në mënyrë të dedikuar? Kush janë anët pozitive të njërit, anët negative të tjetrit.

Klodi ka shumë të drejtë që mekanizmi që propozon Klodi është më i mbështetur në ligj, sepse nuk e kemi aplikuar asnjëherë mekanizmin tjetër, por nga ana tjetër bie ndesh me atë që ne kemi thënë gjithmonë, që ne transferimet e përkohshme do t'i kemi si mjete të jashtëzakonshme, gjë që nuk është rasti i një mjeti të jashtëzakonshëm këtu por këtu është rasti që ne për shkak se nuk arrimë dot të përfundojmë procedurat, kërkojmë që të krijojmë mekanizëm për hapjen e vendeve.

Atëherë, mekanizmi i propozuar nga Brikena, edhe ky është një mekanizëm të cilin ne nuk e kemi aplikuar në fakt, e kemi përdorur vetëm në një situatë për të cilën përdoret. Por ajo që ne na ofron mekanizmi i Brikenës, në kushtet që kemi kaluar goxha kohë, është që na ofron më shumë efektivitet. Pra ne çojmë në mënyrë të dedikuar, për

sa kohë qëllimi i projekt-aktit është dedikimi tek individi përkatës, dhe ne marrim kohë sepse mund t'i lëmë afat 24 orë atyre për të na dhënë “dakord” dhe ne javës tjetër, nga e hëna, nge e marta fillojmë me hapjen e vendeve vakante, dhe nuk presim procedurën ligjore, një javë sa të sjellin, sa të shprehin interesin. Thjesht për efektivitet. Ndërkohë që këtu mund të mbarojmë më shpejt. Kjo është vetëm një zgjedhje që ne duhet ta vlerësojmë të gjithë bashkë këtu. A mendojmë që ta bëjmë këtë apo jo? Të dy mekanizmat janë për të njëjtin qëllim. Nuk kemi diskutime të qëllimit të mekanizmit. Asnjëri as tjetri këtu prej nesh, pavarësisht se bëjmë debate, nuk kemi diskutime. Qëllimi është i njëjtë, ajo që e keni pranuar dhe e kemi thënë tek relacioni.

Marçela Shehu: Unë jam dakord, sepse në relacion është trajtuar shumë qartë qëllimi pse po përdoret mekanizmi. Ne si administratorë të sistemit përzgjedhim këtë mekanizëm si më eficient.

Naureda Llagami: Unë me kryetarin, zotin Kurushi, e kemi diskutuar disa herë dhe kemi pasur të njëjtin shqetësim, llojin e mekanizimit. Jo se donim të vinim me këtë mekanizëm, por që e kuptojmë që jemi sforcuar të shkojmë tek kjo gjëja. Morëm të gjithë masat përkatëse që ndoshta të na ecin proceset më shpejt. Kemi kaluar në masa që kapërcejnë edhe funksionalitetet tona, duke komunikuar me palët, duke u munduar të përshpejtojmë disa procedura. Kjo është situata tani. Prandaj, këto janë dy zgjedhjet. Me procedurë tani, kalojmë në votim propozimin e Brikenës dhe aplikojmë mekanizmin më të shpejt, dhe nëse s'merr shumicën propozimi i Brikenës, kalojmë me mekanizmin normal.

Atëherë, kalojmë në propozimin e Brikenës nëse jemi dakord me propozimin e Brikenës. Hedhim në votim.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e zonjës Ukperaj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i Brikenës për t'i kaluar propozimin drejtpërdrejt personave. Për efikasitet të kohës, a mundemi dot t'i draftojmë projekt-aktet dhe ta kalojmë si çështje në fund për t'i miratuar?

Atëherë, do kalojmë në projekt-akt konkret zonja Ukperaj, jeni gati?

Brikena Ukperaj: Po!

Atëherë, për çdo gjykatë që ne hapim procedurë transferimi të përkohshëm, pika 1 e dispozitivit duhet të jetë "Këshilli vendos të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit z.{...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda tre ditëve.

Naureda Llagami: Unë mendoj të jetë ditën e hënë. Është i arsyeshëm të jetë me datë? Deri të hënë. E hëna është data 9.

Brikena Ukperaj: ...brenda datës 9.10.2023.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Naureda Llagami: E hedhim në votim?

Hedhim në votim propozimi që i drejtohet z. {...}.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër, se vjen në kundërshtim me 46.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet.)

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin tjetër.

Brikena Ukperaj: 1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës znj.{...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e cila ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda datës 09.10.2023.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër, se vjen në kundërshtim me nenin 46.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Brikena Ukperaj: Propozimi: 1. Të shpallet një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit z.{...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda datës 09.10.2023.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim? Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër, se vjen në kundërshtim me 46.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Brikena Ukperaj: 1. Të shpallet një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit z.{...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda datës 09.10.2023.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër, se vjen në kundërshtim me nenin 46.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu):

4.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Naureda Llagami

(kryetare)

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 2. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 4. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Edmond Hoxhaj, BIRN.

8. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu):

4.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe më pas kemi dhe për pozicionin tjetër. Në fakt janë dy pozicione në fushën e të drejtës penale. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Sikurse e cituat, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i paraqet për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare dy projektvendime, projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” si dhe projektvendimin tjetër “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Siç e dini, me këto dy vendime, me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit, KLGJ ka shpallur dy pozicione të lira për ngritjen në detyrë në fushën penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Aktualisht, procedura e përzgjedhjes, pra renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja e kandidatëve me qëllim ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm mund të vijojë dhe të përbyllet për këto dy procedura në rrethanat kur për kandidatët e këtyre pozicioneve të lira ka përfunduar procedura e verifikimit dhe për ata ka dy vlerësime etike dhe profesionale. Citoj që përfundimisht në këto dy procedura ngritjeje në detyrë kandidatët për të cilët ka përfunduar procedura e verifikimit, pra që janë kualifikuar dhe që kanë tashmë dy vlerësime etike dhe profesionale, janë 4 kandidatë, konkretisht: z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores kam administruar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përbylljes së procedurave të përzgjedhjes sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimet e Këshillit nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

Për kandidatin z. {...} për të cilin Këshilli më herët ka vendosur kualifikimin për këto procedura ngritjeje në detyrë, u administruar edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 59 dhe nr. 60, datë 15.02.2022, vendime të cilët janë përfundimtarë.

Për kandidatin z. {...} i cili gjithashtu më herët është kualifikuar për këto procedura ngritjeje në detyrë, janë administruar dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 341 datë 27.06.2023 dhe nr. 460, datë 25.07.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë.

Për kandidaten znj. {...} e cila gjithashtu është kualifikuar për këto procedura ngritjeje në detyrë janë administruar dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 557 dhe nr. 560, datë 01.02.2021, vendime të cilët janë përfundimtarë.

Për kandidaten znj. {...} e cila gjithashtu është kualifikuar në këto procedura ngritjeje në detyrë, janë administruar dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 224, datë 08.05.2023 dhe nr. 459, datë 25.07.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV të Vendimit 70/2020, me cilësinë e relatores kam realizuar renditjen e kandidatëve për

secilin nga dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura nga Këshilli me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke ndjekur rendin kronologjik të shpalljes së tyre.

Sjell në vëmendje që për të realizuar procedurën e renditjes janë respektuar parashikimet e nenit 48 të ligjit “Për statusin”, si dhe parashikimet e vendimit nr.70/2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me renditjen për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, u përfshinë përfundimisht dy kandidatë, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020 të Këshillit.

Siç u parashtua, në pikën 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, ...”. Ndërsa në pikën 12, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart”.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për z. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 341, datë 27.06.2023, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm

“Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 460, datë 25.07.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2019-2020, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

Për z. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 59, datë 15.02.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 60, datë 15.02.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidati z. {...}, të ketë “Shumë mirë” njërin nga nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse kandidati z. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, është e mundur renditja e dy kandidatëve, pra identifikimi i kandidatit me rezultatet më të larta z. {...}.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, rezulton si më poshtë: 1) Z. {...}; 2) Z. {...}.

Kandidati i renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, pra z. {...}, pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të ketë shprehur preferencë kandidimi të parë pikërisht pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, sikurse përcaktohet në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin ku thuhet: “Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”. Për pasojë, për këtë kandidat është e zbatueshme dhe preferenca e kandidimit.

Bazuar në sa përcaktohet më sipër, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 20 të këtij relacioni, është përgatitur dhe projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, si më poshtë: 1) Z. {...}; 2) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Ndërsa në pikën 3 parashikohet që kandidatët mund të bëjnë ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit.

Dhe në fund përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është projektvendimi i parë që i propozohet Këshillit.

Naureda Llagami: Hedhim në votim projekt-aktin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};
2. Z. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve [...].
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. [...].

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë. Sërish relatorja.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, përfundimisht u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}; z. {...}, znj. {...}, z. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit 70/2020 të Këshillit.

Edhe në këtë procedurë përzgjedhjeje, për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Vendimin 70/2020.

Referuar kriterit të parë të renditjes, atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për z. {...} – Sikurse e citova, rezulton që të ketë dy vlerësime në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Për z. {...} – Sipas për vitin 2013-2016, vlerësimi i tij, siç e thashë është në nivelin “Shkëlqyeshëm”; Ndërsa për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 557, datë 1.12.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”; Ndërsa për vitin 2019, është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 224, datë 08.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Dhe po në këtë nivel është vlerësuar edhe për periudhën kohore 2019-2020.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që dy kandidatë, konkretisht z. {...} dhe znj. {...} të kenë “Shkëlqyeshëm” të dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Ndërsa, kandidati z. {...} dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë” dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin , identifikohen dy kandidatë me rezultate më të larta, konkretisht kandidatët {...} dhe znj. {...}, që renditen më lart se kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

Referuar rezultatit të renditjes së kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020, në kushtet kur kandidati {...} renditet i pari në këtë procedurë, rezulton se është rrjedhimisht dhe kandidati potencial i mundshëm për t’u ngritur në detyrë në këtë pozicion. Në këto kushte duhet identifikuar kandidati tjetër, përveç kandidatit {...}, që do të duhet të renditet i pari për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020.

Nisur nga përcaktimet e vendimit 70/2020, ndërsa nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës

penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, konkretisht si më poshtë: 1) Znj. {...}; 2) Z. {...}; 3) Znj. {...}.

Kandidatja e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020, pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të ketë shprehur preferencë kandidimi të parë pikërisht pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185/2020.

Bazuar në sa përcaktohet më sipër, është përgatitur edhe projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve.

Në pikën 2 përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit.

Dhe në fund detyrimi për botimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Këshillit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit të propozuar.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Z. {...};
3. Znj. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve [...].
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. [...].

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023[...].

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, më herët nga ana e Këshillit kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele në disa gjykata të shkallës së parë, ndër të tjera Durrësi dhe Tirana. Pikërisht pozicioni i lirë nr. 19, datë 18.01.2023, ku kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele, është pozicioni i hapur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Një nga kandidatët në këtë pozicion është z. {...} i cili është gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë).

Për këtë gjyqtar janë kryer disa veprime procedurale nga ana e Këshillit me qëllim finalizimin e procedurave të lëvizjes paralele, ku mund të citoj vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 me anë të të cilit është filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës; apo vendimi nr.449, datë 24.07.2023, me anë të cilit është kualifikuar ky kandidat (z. {...}) dhe ka vijuar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu mund të citoj vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor me anë të të cilit është filluar procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndërkohë, nga ana e kandidatit, më datë 13.09.2023 është paraqitur i materializuar vullneti i tij, me anë të të cilit deklaroi se heq dorë nga vijimi i procedurës së lëvizjes paralele për vendin e shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023.

Duke qenë që ky vullnet është parashikuar edhe në aktet tona nënligjore si formë ndalimi e konkurrencës, nga ana e relatorit është përgatitur projekt-akti në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk keni diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Irena Plaku** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Ridvan Hado** (anëtar)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|----------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me transferimin e znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për më shumë detaje, fjalën e ka zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Kam përgatitur relacionin për projektvendimin “Mbi transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 20, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit ishte data 01.02.2023 dhe brenda këtij afati janë paraqitur gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë.

Për këtë pozicion në përfundim të fazës së parë të verifikimit janë kualifikuar nga Këshilli 3 (tre) kandidatë, konkretisht: i) znj. {...}; ii) z. {...}; iii) znj. {...}.

Zoti {...} është renditur i pari në pozicionin nr. 18 dhe Këshilli me vendimin e datës 13.09.2023 ka vendosur transferimin e tij në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përfundim të procedurës së renditjes, Këshilli me vendimin nr. 494, datë 21.09.2023 ka vendosur:

“1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 20, datë 18.01.2023, si më poshtë: 1. Znj. {...}; 2. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidateve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit”.

Vendimi i mësipërm i është komunikuar kandidateve rregullisht. Nëpërmjet komunikimit elektronik datë 22.09.2023 nga ana e kandidatëve është njoftuar se nuk do të ketë ankim për këtë vendim, konkretisht znj, {...} ka njoftuar se: “Konfirmoj marrjen dijeni për vendimin nr.494, datë 21.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Jam dakord me renditjen dhe nuk kam kundërshtime për vijimin e procedurës”; znj. {...} ka deklaruar se: “Duke ju falënderuar për punën e deritanishme, me anë të këtij e-maili ju konfirmoj

marrjen dijani në lidhje me përmbajtjen e vendimit me nr. 494 datë 21.09.2023 të KLGJ-së. Deklaroj se jam dakord dhe nuk kam asnjë kundërshtim”.

Në këto kushte vendimi nr. 494, datë 21.09.2023 është i formës së prerë. Komisioni, në përputhje me përcaktimet e Kreut VII, pika 111 të vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, i propozon Këshillit transferimin e kandidatit të renditur më lart, znj. {...} në pozicionin e lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë përcaktohet - Transferimi i gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

Lidhur me efektet juridike të këtij vendimi, mbajtur në konsideratë: i) situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; ii) emërimet e mundshme të magjistratëve të diplomuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, propozohet që të efektet juridike të vendimit, këtë e kam lënë të hapur ta diskutojmë bashkë, në varësi të datës që do ta diskutojmë të gjithë bashkë.

Në pikën vijuese është që ky vendim t’i njoftohet magjistrates znj. {...} dhe gjykatave përkatëse.

Së fundi, ky vendim hyn në fuqi dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, propozim për datën? Relatori!

Dritan Hallunaj: Datën 16 tetor.

Naureda Llagami: Atëherë, me datë 16 vjen propozimi.

Kalojmë në votim të projekt-aktit ju lutem.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

7.2 “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|----------------------------|------------------|
| 6. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

7.2 “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që kanë të bëjnë me transferimet e gjyqtarëve, z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe më tej transferimin e gjyqtarit z. {...} në të njëjtën gjykatë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Është një relacion i lexuar që në momentin kur kemi dërguar relacionin në atë kohë edhe për renditjen, meqenëse ishte kandidat i vetëm, edhe për transferim. Domethënë kolegët janë të njohur. Është i njëjti relacion i përsëritur edhe një herë. Kjo është pjesa e dytë e relacionit të parë dhe bashkëpropozimi i bërë si për të parën që ka kaluar, edhe propozimi i dytë.

Atëherë, ne përfundimisht, meqenëse janë kandidatë të vetëm pas renditjes së bërë, i propozojmë mbledhjes transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023.

Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është projektvendimi i parë.

Naureda Llagami: E hedhim në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet sipas propozimit të relatorit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i dytë që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit {...}.

Klodian Kurushi: Përfundimisht i propozoj mbledhjes gjyqtarin z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si edhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ai ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim nëse s’kemi diskutime?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).⁷

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për më shumë detaje, fjalën e ka z. Toro. Ndjesë, ia kalojmë fjalën relatorit z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Parashtroj relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele të kandidatës znj. {...}.

Me vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosur hapjen e katërbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 21 deri nr.24, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në këto procedura brenda afatit ka kandiduar dhe kandidatja znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Më tej kanë vijuar procedurat e mëtejshme duke përcaktuar kandidatët në vijim të pikës 9 të vendimit nr. 13, të vitit 2023, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele [...], si dhe caktimin e relatorit (që jam caktuar unë).

Është vijuar pastaj duke iu njoftuar kandidatëve në lidhje me fillimin e procedurës për caktimin e relatorit, për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e një anëtari apo relatorit dhe më tej është vijuar me pritjen e përgjigjeve nga të cilat nuk ka rezultuar që të kishte një kërkesë të tillë.

Është vijuar me rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit, kryesisht që kanë të bëjnë me përvojën profesionale, pasjen e kriterit të përvojës profesionale specifike.

“Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 19, ku ndër të tjera thuhet që: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Për verifikimin e kandidates, u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi, evidentohet se kandidatja ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me dekret nr. {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me vendimin nr. {...}, datë 18.01.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, komandohet Ndhimës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë me një afat 5-vjeçar. Me vendim nr. 33, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor konfirmohet si Ndhimësmagjistrat në Gjykatën e Lartë dhe i përsëritet mandati i komandimit me 3 (tre) vite, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Sipas informacionit të sjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet (siç u deklarua më lart nga vetëdeklarimi dhe nga aktet e ardhura nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative).

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, nga verifikimet e kryera rezulton që: “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. {...} prot., datë 14.07.2023 ku kërkonte informacion në lidhje me përvojën profesionale specifike si gjyqtar në fushën e të drejtës civile si dhe

ne vijim të komunikimeve të pasura me ju në lidhje me magjistraten znj. {...} ju informoj si më poshtë vijon: Me vendimin nr. {...}, datë 18.01.2018 KLD-ja ka vendosur komandimin e znj. {...} në Njësinë e Shërbimit Ligjo... dhe vijon shkresa duke përcaktuar përcaktimet përkatëse dhe emërimet që ka marrë nga KLD-ja dhe nga KLGJ-ja, pra me vendimin nr.33, datë 18.01.2023, duke vendosur përsëritjen e mandatit, duke e ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit Civil”.

Nga të dhënat që disponohen nga dokumentacioni i administruar konkludohet se zonja {...}, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 19, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe rezulton që nuk ka masë disiplinore, pasi Departamenti i Burimeve Njerëzore ka paraqitur edhe shkresën përkatëse.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Papajtueshmëria ambientale është përcaktuar në akt se çfarë përfaqëson dhe nga dokumentacioni i paraqitur i administruar për kandidaten znj. {...}, nuk vërtetohet që ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak, ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s’kemi diskutime, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro. Vetëm kam një qëndrim për të shpjeguar arsyen e votës time. Sipas nenit 43, pika 6, magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë 5 viteve të fundit nuk ka të paktën 1 vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës, domethënë ligji nuk e lidh përvojën me përvojën si gjyqtar. Pra në vlerësimin tim, zonja nuk e ka përvojën si gjyqtare, e ka përvojën si ndihmësmagjistrat, pavarësisht se është një përvojë e tillë, ajo përfshihet brenda fushës së zbatimit të nenit 43, pika 6 (në vlerësimin tim). E mbaj këtë qëndrim, sepse do kemi edhe kandidatura të tjera.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, (të datave: 17.07.2023, 18.07.2023, 19.07.2023 dhe 24.07.2023).⁸

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, (të datave: 17.07.2023, 18.07.2023, 19.07.2023 dhe 24.07.2023).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me procesverbalet. Janë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 17, 18 korrik, 19 korrik, 24 korrik.

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, atëherë kalojmë në miratimin e tyre.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e procesverbaleve për datat 17, 18, 19 dhe 24 korrik.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ashtu sikurse ju thashë edhe në fillim, për dy aktet/çështjet e fundit që janë fillimi i procedurës së vlerësimit, pra në thelb është thjesht hedhja e shortit për relatorin dhe nëpunësin përgjegjës dhe caktimi i çështjeve për gjykatat në nevojë, mund t'i bëjmë “online” për të mundësuar që të vijojmë.

Alban Toro: Në lidhje me pikën që ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, në momentin që caktohet relatori dhe nëpunësi përgjegjës edhe për zonjën Toro, jam i detyruar, konform 72, 74 të mos marrë pjesë në votim, as në diskutim, për të evituar çfarëdo lloj, të themi edhe konfliktin e interesit në rastin konkret. Është relatori dhe nëpunësi, dhe thotë nesër–pasnesër, e ka caktuar Albani. Për të qenë i drejt me çdo njeri. Kështu që mua mos më llogarit tek pjesa e kësaj pike.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 2-ta sipas rendit të ditës.

7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Largohet nga mbledhja Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe çështjes së fundit të rendit të ditës.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Pas pushimit, rifillon mbledhja plenare nën drejtimin e z. Ilir Rusi,

Zëvendëskryetar i Këshillit. Gjithashtu pak më herët (shih procesverbalin e pikës 9) edhe zoti Toro është larguar nga mbledhja.

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes vazhdojmë me shqyrtimin e pikës përkatëse që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Projekt-akti që i është propozuar për miratim mbledhjes plenare ka për qëllim fillimin e procedurës së gradimit për gjyqtarët të cilët janë konfirmuar me vendim të formës së prerë dhe për të cilët janë përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dosjet e vlerësimit profesional, dosje të përcjella deri në datën 26.09.2023. Konkretisht kemi gjithsej 17 gjyqtarë, të cilët do fillojnë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi. Këta janë gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, duke qenë se një pjesë e këtyre gjyqtarëve kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë dhe një pjesë jo, kemi menduar si Komision që shorti të hidhet në dy faza, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të punës midis 3 anëtarëve të Komisionit për vlerësimet që kanë përparësi dhe që janë vlerësimet të cilat kërkohen për efekt të ngritjes në detyrë dhe pastaj një short i dytë për caktimin e relatorit dhe nëpunësit për vlerësimet që janë gradime por që nuk kanë përparësi dhe nuk kanë urgjencën që kërkohet nga ngritja në detyrë.

Konkretisht, në procedurën e parë të shortit në të cilën janë përfshirë 9 gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, kemi propozuar që të përfshihen në short tre anëtarët e Komisionit me një shpërndarje të barabartë nga 4

vlerësime secila (pra janë 12 vlerësime). Ndërkohë që tre nëpunëset përgjegjëse të vlerësimit do të marrin një ngarkesë pune me nga katër vlerësime secila.

Në hapin e dytë të shortit, ku janë gjyqtarët që nuk kanë aplikuar për ngritjen në detyrë: {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, të përfshihen vetëm dy nga anëtarët e Komisionit znj. Rupa dhe znj. Plaku me një ngarkesë pune znj. Rupa dy vlerësime gradimi dhe znj. Plaku tre vlerësime gradimi. Ndërkohë që për sa i përket nëpunësve përgjegjës, znj. Gilda Hoxha, znj. Esmerilda Habili dhe znj. Erlanda Agaj me një ngarkesë pune të tillë: znj. Gilda Hoxha 1 (një) vlerësim, znj. Esmerilda Habili 2 (dy) vlerësime dhe znj. Erlanda Agaj 2 (dy) vlerësime.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni propozon të fillohet me përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, dhe më pas përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, duke futur për çdo hap shorti, në një vazo emrat e gjyqtarëve, në një vazo tjetër emrat e relatorëve aq herë sa numri i procedurave të vlerësimit që ata do të përfshihen dhe sipas të njëjtit parim edhe në vazon e fundit emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin.

Faleminderit!

Relacioni është dërguar kështu që vajzat janë të informuara për procedurën e shortit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për mekanizmin e shortit të prezantuar nga relatorja?

Gjithashtu vlen të theksohet fakti që në votimin e këtij projektvendimi, pas hedhjes së shortit, zoti Toro nuk do të jetë pjesëmarrës në votim, për shkak se pjesë e këtij procesi është edhe gjyqtarja znj. {...}.

Procedura e parë e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë emrat e 12 gjyqtarëve: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

80

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj (4 shirita letre me emrin e saj); znj. Irena Plaku (4 shirita letre me emrin e saj); znj. Yllka Rupa (4 shirita letre me emrin e saj).

Në enën e tretë të qelqit futen me radhë emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj. Gilda Hoxha (4 shirita letre me emrin e saj); znj. Esmerilda Habili (4 shirita letre me emrin e saj); znj. Erlanda Agaj (4 shirita letre me emrin e saj).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur numri 12, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur numri 6, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur numri 13, {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i katër i përzgjedhur numri 3, {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i pestë i përzgjedhur numri 7, {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i gjashtë i përzgjedhur numri 15, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i shtatë i përzgjedhur numri 2, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i tetë i përzgjedhur numri 14, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i nëntë i përzgjedhur numri 17, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i dhjetë i përzgjedhur numri 16, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i njëmbëdhjetë i përzgjedhur numri 4, {...}. Relatore për znj. {...}

përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i dymbëdhjetë i përzgjedhur numri 8, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Procedura e dytë e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë emrat e 5 gjyqtarëve: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë emrat e relatorëve: znj. Irena Plaku (3 shirita letre me emrin e saj); znj. Yllka Rupa (2 shirita letre me emrin e saj).

Në enën e tretë të qelqit futen me radhë emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj. Gilda Hoxha (1 shirit letre me emrin e saj); znj. Esmerilda Habili (2 shirita letre me emrin e saj); znj. Erlanda Agaj (2 shirita letre me emrin e saj).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur numri 5, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur numri 1, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur numri 11, Fahrie Stringa. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i katërt i përzgjedhur numri 9, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i pestë i përzgjedhur numri 10, {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Ilir Rusi: Falenderojmë administratën për hedhjen e shortit. Ka diskutime mbi

projektvendimin, duke iu bashkangjitur edhe relatorët dhe nëpunësit përgjegjës sipas shortit të hedhur?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës, duke theksuar faktin që zoti Alban Toro nuk është pjesë e këtij votimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

2. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

3. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;
4. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;
5. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;
6. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
7. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
8. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;
9. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
10. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
11. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;
12. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;
13. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
14. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;
15. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;
16. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

17. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.10.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁰

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 13:46.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

¹⁰ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Largohet nga mbledhja Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe çështjes së fundit të rendit të ditës.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, për të cilën janë përgatitur relacionet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Kurushi i cili parashtroi relacionet e përgatitura lidhur me kërkesat e ardhura nga disa gjykata.

Fillimisht parashtrohet relacioni për kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**, e cila ka paraqitur kërkesë për caktimin e gjyqtarëve në 5 çështje penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, konkretisht: z. {...}.

Të përjashtohet nga shorti, z. {...}, për shkak se ai ndodhet në procesin e rivlerësimit në KPA.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale (kërkesa me nr. 127), gjyqtarët Besmir Stroka dhe Sokol Shehu.

Për çështjen nr. 5, penale (kërkesa me nr. 808), gjyqtari Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 4, penale (kërkesa me nr. 128), gjyqtarët Sokol Shehu dhe Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 2, penale (kërkesa me nr. 136), gjyqtari Sokol Shehu.

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa me nr. 97), gjyqtari Besmir Stroka.

Parashtrohet relacioni për kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**, e cila ka paraqitur kërkesë për caktimin e gjyqtarëve në 1 çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtare {...}. Gjyqtaret {...} dhe {...} kanë kryer hetime paraprake. Gjyqtari Pëllumb Zaimi ka gjykuar kërkesën për caktim mase sigurimi; gjyqtare {...} ka gjykuar seancën paraprake.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, konkretisht: znj. {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa me nr. 398), gjyqtarët Miranda Nakaj, Ersida Bajgora.

Parashtrohet relacioni për kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër**, e cila ka paraqitur kërkesë për caktimin e gjyqtarëve në 1 çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Gjyqtare {...} ka disponuar me vendimin e dërgimit për gjyq; gjyqtari Gjergji Baçi ka disponuar me vendimin e përgjimit në fazën e hetimeve paraprake.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, konkretisht: znj. {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa me nr. 110), gjyqtarja Dejvi Çelçima.

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor